



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2019:205828

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05745597

C.nr.440/17

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri në çështjen juridike kontestimore të paditësit S. K.nga M., të cilin me autorizim e përfaqëson Dardan Morina avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e sigurimeve “Elsig” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti “Kompensim dëmi”, vlera e kontestit 1,000.00 (Njëmijë) euro, në seancën e mbajtur me datë 28 maj 2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. **KONSIDEROHET e tërhequr** padia e paditësit S. K.nga M., (lënda me shenjë C.nr.440/17 e datës 20.12.2017), kundër të paditurës Kompania e sigurimeve “Elsig” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti “Kompensim dëmi”.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

A r s y e t i m

Paditësi S. K.nga M., përmes të autorizuarit të tij Dardan Morina avokat nga Prizreni, me datë 20.12.2017, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Elsig” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti “Kompensim dëmi”, vlera e kontestit 1,000.00 euro.

Lidhur me këtë çështje juridike kontestimore, gjykata me datë 28.02.2024 ka nxjerrë aktvendim për përgjigje në padi dhe të njëjtën ia ka dërguar të paditurës, e cila nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa me datë 28.05.2024, gjykata ka caktuar seancën përgatitore me fillim prej orës 10:20, ku i autorizuari i paditësit për këtë seancë ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt dhe kjo vërtetohet sipas procesverbalit të datës 28.05.2024, por në këtë seancë nuk është paraqitur, mungesën nuk e ka arsyetuar dhe shtyrjen nuk e ka kërkuar, e në të cilën seancë nuk ka qenë prezent as i autorizuari i të paditurës.

Lidhur me këtë, gjykata ka prova se i autorizuari i paditësit, ftesën e ka pranuar me datë 17.05.2024 dhe kjo vërehet edhe nga nënshkrimi në fletë kthesë, megjithatë mungesën nuk e ka arsyetuar në asnjë formë, kurse e paditura ftesën e ka pranuar me datë 20.05.2024, mirëpo askush nuk ka qenë prezent.

Në rastin konkret, duke aplikuar nenin 409 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore ku parashihet se: *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet”* dhe faktin se paditësi ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, ai nuk ka prezantuar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, atëherë gjykata erdhi në përfundim se duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Nga të lartcekurat dhe në mbështetje të nenit 409 par. 1 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.440/17, datë 28.05.2024

Gj y q t a r i
Petrit Curri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.